



Republika e Kosovës
Republika Kosova • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Nr./Br./No. 2364/2018
Nr.i fqjBr.str./Nr.pg. 0211118
Data/Datum/Date: 02/11/18



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Raport me rekomandime

Ex officio nr. 12/2018

Institucioni i Avokatit të Popullit
kundër

Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

lidhur me mosndërmarrjen e obligimeve pozitive nga organet kompetente
për menaxhimin e mbeturinave me përbajtje asbestos

- Z. Kadri Veseli, Kryetar, Kuvendi i Kosovës
Z. Ramush Haradinaj, Kryeministër, Qeveria e Republikës së Kosovës
Z. Fatmir Matoshi, Ministër, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Z. Muhamet Nitaj, Kryetar, Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor
Z. Shpend Ahmeti, Kryetar, Komuna e Prishtinës
Z. Ardiq Gjini, Kryetar, Komuna e Gjakovës
Z. Lutfi Haziri, Kryetar, Komuna e Gjilanit
Z. Agim Bahtiri, Kryetar, Komuna e Mitrovicës
Z. Mytaher Haskuka, Kryetar, Komuna e Prizrenit
Z. Gazmend Muhaxheri, Kryetar, Komuna e Pejës
Z. Agim Aliu, Kryetar, Komuna e Ferizajt

Prishtinë, më 7 nëntor 2018

Qëllimi i raportit me rekomandime

1. Ky Raport me rekomandime bazohet në hetimet e filluara nga Avokati i Popullit, sipas detyrës zyrtare (*Ex officio*), lidhur me çështjen e menaxhimit të mbeturinave me përmbajtje asbesti në territorin e Republikës së Kosovës.
2. Bazuar në informata që i ka Institucioni i Avokatit të Popullit, vërehet se, pavarësisht rrezikut që përbëjnë materialet me përmbajtje azbesti për jetën dhe shëndetin e qytetarëve, si dhe ndikimi i tyre në mjedis, materiali në forma të ndryshme vazhdon të mbetet mjaft i pranishëm në hapësirat e hapura, i pa kontrolluar, i pa menaxhuar, pa masa parandaluese, që do të evitonin ndikimin negativ në mjedis. Edhe pse ish-sistemi, pjesë e të cilit ishte edhe Kosova, kishte nënshkruar Konventën e Këshillit Ekonomik Evropian - Direktivën 76/769 / EEC të 27 korrikut 1976, e cila ndalon përdorimin e asbestosit¹, materialet me përmbajtje asbesti janë përdorur vazhdimisht. Përveç në çati, asbesti vërehet shpeshherë edhe në formë të mbeturinave të pa trajtuar, madje edhe brenda vendbanimeve në tërë territorin e vendit në kundërshtim me kriteret e përcaktuara me Ligjin për Mbeturinat dhe Udhëzimin Administrativ nr. 22/2015 për Menaxhimin e mbeturinave që përmbajnë asbest.
3. Raporti ka për qëllim të térheqë vëmendjen e autoriteteve kompetente, gjegjësisht të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe komunave, për nevojën e ndërmarrjes së masave të menjëherëshme parandaluese, në mënyrë që të reduktohen efektet negative në mjedis dhe në shëndetin e njeriut.

Baza ligjore

4. Kushtetuta e Republikës së Kosovë, në nenin 135, paragrafin 3, përcakton se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore*”.
5. Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit ka kompetenca:
 - ”*për t'i hetuar ankesat e pranuara nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me Kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit*” (neni 16, paragrafi 1);
 - ”*të hetojë shkeljet e pohuara të të drejtave të njeriut dhe veprimet e diskriminimit dhe të angazhohet për eliminimin e tyre*” (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1);
 - ”*të térheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tillë dhe kur është e domosdoshme të*

¹Asbestos as Environmental and Legal Issue, Vanja-Ivan Savića, Hana Fajkovićb, Department for General Theory of Law and State, Faculty of Law, University of Zagreb,

bDepartment of Geology, Faculty of Science, University of Zagreb, ”The former Yugoslavia had signed the Convention of European Economic Council- Directive 76/769/EEC of 27 July 1976 which forbids the use of asbestos (firstly mineral crisotyle)“.

shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tillë” (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2);

- “*të bëjë të njohura të drejtat e njeriut dhe përpjekjet për të luftuar të gjitha format e diskriminimit përmes ngritjes së vetëdijesimit, posaçërisht përmes informimit dhe edukimit edhe me anë të mediave” (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.4);*
- “*t’u rekomandojë Qeverisë, Kuvendit dhe autoritetete tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit” (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.5);*
- “*t’i publikojë rjoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta” (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6);*
- “*Avokati i Popullit mund t’i këshillojë dhe t’u rekomandojë autoritetete të Republikës së Kosovës për programet dhe politikat e tyre për të siguruar mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Kosovës” (neni 18, paragrafi 3).*

Obligimi për bashkëpunim me Avokatin e Popullit

6. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 132, paragrafi 3, parashevë decidivisht obligimin e të gjitha institucioneve për t’u përgjigjur në kërkesat e Avokatit të Popullit.
 - “*Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkua të pajtim me ligjin.*”
7. Po ashtu, Ligji për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, ka përcaktuar detyrimin e të gjitha autoriteteteve për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit. Sipas nenit 18, paragrafi 6, të ligjit, parashihet që:

“Avokati i Popullit ka qasje në dosjet dhe në dokumentet e çdo autoriteti të Republikës së Kosovës, ... mund të kërkojë nga çdo autoritetet i Republikës së Kosovës dhe nga personeli i tyre të bashkëpunojnë me Avokatin e Popullit, duke siguruar informacione relevante, përfshirë edhe kopjen e plotë apo të pjesshme të dosjes dhe dokumenteve sipas kërkesës së Avokatit të Popullit”.

8. Ndërsa neni 25 i Ligjit për Avokatin e Popullit, ka paraparë ja vetëm obligimin për bashkëpunim, por edhe pasojat e refuzimit.

“1. Të gjitha autoritetet kanë për obligim t’i përgjigjen Avokatit të Popullit në kërkesat e tij për zhvillimin e hetimeve, si dhe t’i ofrojnë ndihmë adekuate sipas kërkesës së tij.

9. 2. Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose nga autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga organi kompetent fillimin e procedurës administrative duke përfshirë marrjen e masave disiplinore, deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil”.

10. Për më tepër, paragrafi 3 i nenit të lartpërmendur përcakton se:

“3. Në rastin kur institucioni refuzon të bashkëpunojë ose ndërhynë në procesin e hetimit, Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë nga prokuroria kompetente fillimin e procedurës ligjore për pengimin e kryerjes së detyrës zyrtare”.

Veprimet e Avokatit të Popullit

11. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16.4 të Ligjit për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019, më 16 janar 2018 ka iniciuar procedurën hetimore sipas detyrës zyrtare (*Ex officio*), lidhur me masat e ndërmarra nga organet kompetente për parandalimin e ndotjes me asbest të mjedisit.

12. Më 18 janar 2018, Avokati i Popullit iu drejtua me letër ministres së atëhershme të MMPH-së, nga e cila kërkoi të njoftohet për masat e ndërmarra nga Ministria që ajo udhëheq si organ kompetent për mbikëqyrjen administrative të menaxhimit të mbeturinave me përbajtje të asbestit për:

- *parandalimin dhe trajtimin e mbeturinave që përbajnjë asbest;*
- *vetëdijesimin e publikut për ndikimin e asbestit në shëndetin dhe jetën e tyre si dhe në mjedis;*
- *vetëdijesimin e publikut për mënyrat e trajtimit të materialit të kësaj natyre;*
- *caktimin nga autoritetet lokale të lokacioneve dhe vendit për deponimin e mbeturinave me asbest;*
- *mbikëqyrjen inspektive dhe cilat veprime janë ndërmarrë;*
- *a posedon Ministria informata, ndonjë hulumtim të vtin, të ndonjë autoriteti apo projekti tjetër, për çështjen”.*

13. Më 22 janar 2018, Avokati i Popullit iu drejtua me letër kryetarit të Komunës së Prishtinës, nga i cili kërkoi të njoftohet se cilat masa i ka ndërmarrë Komuna s'i autoritet kompetent² për:

- *Caktimin e lokacionit dhe vendit për deponimin e mbeturinave që përbajnjë asbest;*
- *Dhënien e lejes për vendosjen dhe deponimin e mbeturinave me asbest në vendet ku është vlerësuar që nuk shkaktohet ndotja e mjedisit;*
- *Mbikëqyrjen e detyrueshme komunale të personave nga inspektorati komunal, të cilët menaxhojnë mbeturinat me asbest;*
- *Lëshimin e lejeve nga organet kompetente komunale për caktimin e lokacionit për vendosjen e mbeturinave për personat e licencuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;*

² Neni 11 i Udhëzimit Administrativ Nr. 22/2015 për Menaxhimin e Mbeturinave që Përbajnjë Azbest

- *Vetëdijesimin e publikut për ndikimin e asbestit në shëndetin dhe jetën e tyre, në mjeshtësi dhe përmenyrat e trajtimit të materialit të kësaj natyre;*
- *Çështjen se a posedon komuna informata, ndonjë hulumtim të vetin, të ndonjë autoriteti apo projekti tjetër lidhur me çështjen”.*

14. Më 22 janar 2018, Avokati i Popullit iu drejtua me letër kryetarit të Komunës së Gjilanit, nga i cili kërkoi që të njoftohet lidhur me menaxhimin e asbestit.
15. Më 22 janar 2018, Avokati i Popullit iu drejtua me letër kryetarit të Komunës së Mitrovicës, nga i cili kërkoi që të njoftohet lidhur me menaxhimin e asbestit.
16. Më 22 janar 2018, Avokati i Popullit iu drejtua me letër kryetarit të Komunës së Prizrenit, nga i cili kërkoi që të njoftohet lidhur me çështjet e menaxhimit të asbestit.
17. Më 22 janar 2018, Avokati i Popullit iu drejtua me letër kryetarit të Komunës së Pejës, nga i cili kërkoi që të njoftohet lidhur me çështjet e menaxhimit të asbestit.
18. Më 22 janar 2018, Avokati i Popullit iu drejtua me letër kryetarit të Komunës së Ferizajt, nga i cili kërkoi që të njoftohet me çështjet që kanë të bëjnë me menaxhimin e asbestit.
19. Më 22 janar 2018, Avokati i Popullit iu drejtua me letër kryetarit të Komunës së Gjakovës, nga i cili kërkoi që të njoftohet me çështjet përmenaxhimin e asbestit.
20. Më 26 janar 2018, Avokati i Popullit pranoi përgjigje nga kryetari i Komunës së Mitrovicës, nga i cili u njoftua se menaxhimi i mbeturinave me asbest është një ndër synimet e Komunës së Mitrovicës.
21. Më 6 shkurt 2018, Avokati i Popullit, pranoi përgjigje nga kryetari i Komunës së Prizrenit.
22. Më 26 janar 2018, Avokati i Popullit pranoi përgjigje nga Komuna e Pejës.
23. Më 7 mars 2018, Avokati i Popullit, meqenëse nuk pranoi përgjigje nga kryetari i Komunës së Prishtinës, iu drejtua përmes formës së shkruar me tē njëjtën letër.
24. Më 7 mars 2018, Avokati i Popullit pranoi përgjigje nga Komuna e Ferizajt.
25. Më 8 mars 2018, Avokati i Popullit, meqenëse nuk pranoi përgjigje nga ministria e MMPH-së, iu drejtua sërisht me tē njëjtën letër.
26. Më 8 mars 2018, Avokati i Popullit, meqenëse nuk pranoi përgjigje nga kryetari i Komunës së Gjilanit, iu drejtua me letrën e dytë përsëritëse.
27. Më 22 mars 2018, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit takoi drejtorin e Shërbimeve Publike në Komunën e Prishtinës, nga i cili kërkoi informata lidhur me arsyen e vonesës përmes formës së shkruar me tē njëjtën letër.
28. Më 23 mars 2018, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit takoi këshilltaren e ministres së MMPH-së, nga e cila kërkoi informata lidhur me arsyen e vonesës përmes formës së shkruar me tē njëjtën letër.

mbeturinave me përmbajtje asbesti, si dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi. Më 28 mars 2018, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit, përmes postës elektronike iu drejtua drejtorit të Shërbimeve Publike në Komunën e Prishtinës lidhur me këtë çështje.

29. Më 30 mars 2018, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit takoi udhëheqësen e Zyrës për Informim në Komunën e Prishtinës, nga e cila kërkoi informata për arsyen e vonesës për përgjigje në kërkesën e Avokatit të Popullit. Meqenëse e njëjta nuk kishte njohuri lidhur me çështjen, kërkoi t'i drejtohami përmes formës së shkruar.
30. Më 16 prill 2018, Avokati i Popullit lidhur me çështjen e asbestit, në emisionin “Puls”, diskutoi për rrezikun që përbën mostrajtimi i duhur i materialeve me asbest dhe ndikimin në shëndet dhe mjesdis, si dhe në të drejtat e njeriut.
31. Më 23 prill 2018, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit, përmes postës elektronike iu drejtua udhëheqësen e Zyrës për Informim në Komunën e Prishtinës lidhur me këtë çështje. Bashkangjitur kopjet e skanuara të Avokatit të Popullit.
32. Më 24 prill 2018, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit, lidhur me çështjen, përmes postës elektronike iu drejtua këshilltares së ministres së MMPH-së. Bashkangjitur kopjet e skanuara të Avokatit të Popullit.
33. Më 26 prill 2018, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit takoi kryetarin e Komunës së Gjakovës, nga i cili kërkoi informata lidhur me arsyen e vonesës për përgjigje në kërkesën e Avokatit të Popullit dhe veprimet e ndërmarra nga komuna për menaxhimin e mbeturinave me përmbajtje asbesti. Kryetari njoftoi se nuk kishte njohuri lidhur me çështjen, dhe përmes procedura të shpejta do t'i përgjigjet Avokatit të Popullit.
34. Më 11 maj 2018, Avokati i Popullit pranoi përgjigje nga Komuna e Gjakovës.
35. Më 25 maj 2018, Avokati i Popullit iu drejtua përmes letrës së tretë ministres së MMPH-së, nga e cila kërkoi përgjigje urgjente në kërkesën e tij.
36. Më 13 qershor 2018, Avokati i Popullit takoi ministren e MMPH-së, nga e cila kërkoi arsyen për mospërgjigje në letrat e drejtuara lidhur me çështjen e asbestit. Nga ministria u kuptua se nuk kishte njohuri lidhur me çështjen, dhe se do t'i përgjigjet kërkësës së Avokatit të Popullit. Avokati i Popullit dhe ministria e atëherershme diskutuan mundësitë e bashkëpunimit në promovimin dhe edukimin e publikut përkitazi me çështjen.
37. Më 27 qershor 2018, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit kontaktoi këshilltarin e ministres së MMPH-së dhe nga ai kërkoi të njoftohet për arsyen e mospërgjigjes në kërkesën e Avokati i Popullit.
38. Më 13 korrik 2018, bazuar në informatat e pranuara nga burime tjera, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit kontaktoi udhëheqësin e organizatës joqeveritare “*Pro Vitae*”, e cila ka udhëhequr projektin që ka hulumtuar materialet e asbestit në ndërtesat publike në Komunën e Pejës dhe në atë të Istogut.
39. Më 17 korrik 2018, Avokati i Popullit ka pranuar përgjigje nga udhëheqësi i projektit të lartpërmendur, nga i cili u kuptua se projekti është kryer në bashkëpunim me MMPH-në, AMMK-në, Komunën e Pejës dhe atë të Istogut. Projekti kishte për qëllim hulumtimin e

materialeve të asbestit në të gjitha ndërtesat publike të dy komunave të lartpermendura. Gjatë projektit është bërë heqja e kulmit të një shkolle në Pejë dhe trajnimi i stafit përmenyrën e heqjes së asbestit dhe menyrën e deponimit të mbetjeve. Sipas udhëheqësit të projektit, raporti dhe hulumtimi sipas marrëveshjes është pronë e MMMPH-së, dhe si i tillë i është dorëzuar Ministrisë.

40. Më 26 korrik 2018, Avokati i Popullit pranoi përgjigje lidhur me çështjen nga Komuna e Gjilanit.

Përgjigjet e Komunave

Komuna e Mitrovicës

41. Komuna e Mitrovicës, përmes përgjigjes më datë 26 janar 2018, ka informuar Avokatin e Popullit se Komuna kishte caktuar lokacionin përvendosjen e mbeturinave që përmbajnë asbest.
42. Përmes përgjigjes është kuptuar se Komuna ka hartuar dhe draftuar Planin lokal përbeturina inerte nga ndërtimi, prishjet dhe mbeturinat që përmbajnë asbest, i cili është proceduar përmiratim në Kuvendin e Komunës, dhe po ashtu kishin proceduar dhëni e lejes në DMMP.
43. Komuna e Mitrovicës nuk ka pranuar kërkesë përtuajtur me leje nga personat e licencuar nga MMMPH-ja, përcaktimin e lokacionit përvendosje të mbeturinave që përmbajnë asbest.
44. Lidhur me çështjen e organizimit të fushatave vetëdijesuese, Avokati i Popullit u njoftu se Komuna organizon çdo vit fushata të tilla përmenaxhimin e mbeturinave, në veçanti atyre me asbest.
45. Letra nuk është shoqëruar me dokumente faktike.

Komuna e Prizrenit

46. Komuna e Prizrenit, përmes përgjigjes më datë 6 shkurt 2018, nuk ka dhënë asnjë informatë lidhur me kërkesën e Avokatit të Popullit, përmasat e ndërmarra nga Komuna përmenaxhimin e mbetjeve me përmbajtje asbesti, por ajo është fokusuar në dhëni e sqarimeve përkitazi me menaxhimin e mbeturinave komunale.
47. Edhe pse Udhëzimi Administrativ³ qartazi i saktëson detyrat e Komunës, që të caktojë lokacionin dhe vendin përdonimin e mbeturinave me asbest, mungesën e ndërmarrjes së veprimeve lidhur me këtë çështje Komuna e adreson në drejtim të mungesës së veprimeve nga MMMPH-ja, pasi që ata nuk kanë pasur “*asnje kërkesë nga MMMPH-ja, si përgjegjëse kryesore përmenaxhimin e mbeturina të rrezikshme apo ndonjë operator privat*”.
48. Komuna e Prizrenit nuk ka ofruar asnjë informatë lidhur me ndërmarrjen e veprimeve për vetëdijesimin e publikut përmenaxhimin e mbeturinave me asbest në mëdisë dhe shëndetin e njeriut.

³ Udhëzimit Administrativ nr. 22/2015 përmenaxhimin e mbeturinave që përmbajnë Azbest, Obligimet e autoriteteve kompetente, nen 11, paragrafi 1, 2

49. Letra nuk është shoqëruar me dokumente faktike.

Komuna e Pejës

50. Nga përgjigjja e Komunës së Pejës, datë 6 shkurt 2018, Avokati i Popullit u njoftua se Komuna është duke e shqyrtuar mundësinë për gjetjen e lokacionit të ri, i cili do të shërbejë si lokacion për mbetjet nga asbesti. Komuna po ashtu njoftoi se nuk ka pasur kërkesë për dislokim të ndonjë çatie apo diçka të ngashme, dhe se planifikohet të bëhet ndërrimi i çative në dy shkolla.
51. Sipas përgjigjes së Komunës së Pejës, ata nuk kishin pranuar ndonjë kërkesë për dislokim të ndonjë çatie apo diçka të ngashme, dhe që Komuna në një periudhë afatmesme planifikon të bëjë ndërrimin e çative në 2 shkolla (një në Pejë dhe një në Baran).
52. Lidhur me vetëdijesimin e publikut për ndikimin e materialeve nga asbesti në mjedis dhe shëndetin e njeriut, Komuna e Pejës edhe pse njoftoi se ka pasur shumë programe vetëdijesuese, nuk ka dhënë asnjë informatë se kur dhe nga kush janë ndërmarrë ato fushata vetëdijesimi. Sipas Komunës, një gjë e tillë do të organizohet vazhdimi.
53. Po ashtu, kjo Komunë nuk ka ofruar asnjë dokument i cili do të argumentonte ndonjë veprim të Komunës si obligim për menaxhimin e mbeturinave me përbajtje asbesti.

Komuna e Ferizajt

54. Nga përgjigjja e pranuar nga Komuna e Ferizajt, më 7 mars 2018, kuptohet se kjo komunë nuk ka ndërmarrë asnjë veprim në drejtim të trajtimit të mbeturinave me përbajtje të asbestit. Trajtimi i materialeve në fjalë nuk ishte paraparë madje as në Planin komunal për menaxhimin e mbeturinave. Nga përgjigjja kuptohet vetëm se çështja e ndarjes së ngastrës adekuate për trajtimin e “këtyre mbeturinave” mbetet të diskutohet në njëren nga mbledhjet e kuvendit komunal.

55. Letra nuk është shoqëruar me dokumente faktike.

Komuna e Prishtinës

56. Nga përgjigjja e pranuar nga Sektori i Shërbimeve Publike i Komunës së Prishtinës, më datë 25 prill 2018, kuptohet se kjo komunë, edhe më e madhja në vend, dhe gjeneruesi më i madh i mbeturinave, nuk ka ndërmarrë asgjë të veçantë për menaxhimin e mbeturinave me përbërje asbesti.
57. Komuna e Prishtinës përmes letrës njofton po ashtu se as në kuadër të ministrisë përkatëse nuk ka ndonjë hap konkret. Sipas tyre, “deri tani nuk ka ndonjë interesim për licencim të personave apo kompanive për trajtimin dhe menaxhimin e këtij lloji të mbeturinave”.
58. Përgjigjja e Komunës së Prishtinës nuk përmban asnjë informatë lidhur me pyetjet e Avokatit të Popullit që kanë të bëjnë me edukimin e publikut për menaxhimin e mbeturinave me përbajtje asbesti në përputhje me legjislacionin në fuqi.
59. Letra nuk është shoqëruar me dokumente faktike.

Komuna e Gjakovës

60. Përmes përgjigjes së Komunës së Gjakovës, më 11 maj 2018, kuptohet se kjo komunë nuk ka caktuar lokacion për mbetjet e asbestit, ashtu sikurse parashihet në UA.
61. Në vazhdim u kuptua se Komuna e Gjakovës është në procedurë të marrjes së lejes mjedisore nga MMPH-ja për ngritjen dhe ndërtimin e deponisë së mbeturinave nga rrënimi dhe konstruktimi-demolimi i objekteve, e cila do të përdorej edhe për deponimin e mbeturinave me asbest. Po ashtu, Komuna nuk ka pranuar kërkesa nga operatorët e licencuar. Gjithashtu u kuptua se Komuna është në fazën e marrjes së lejes mjedisore në MMPH për ndërtimin e deponisë mjedisore, e cila do të përdorej edhe për mbetjet që përbajnë asbest.

62. Letra nuk është shoqëruar me dokumente faktike.

Komuna e Gjilanit

63. Në përgjigen e Komunës së Gjilanit, më 26 korrik, Avokati i Popullit u njoftua se kjo komunë në Planin Zhvillimor të Komunës 2008-2015, i miratuar nga Asambleja komunale dhe e lejuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, nuk ka planifikuar lokacion për vendosjen e mbeturinave me asbest.
64. Sipas përgjigjes kuptohet se deponia rajonale në fshatin Veleknicë nuk i plotëson kushtet për deponimin e mbetjeve inerte dhe atyre me asbest.
65. Nga përgjigjja kuptohet se Komuna e Gjilanit ka pasur vetëm një kërkesë për “varrosjen” e mbetjeve me asbest.
66. Komuna e Gjilanit shprehu shqetësimin për përdorimin e gypave të ujësjellësit me asbest, mirëpo, sipas saj, nuk kishte informata lidhur me sasinë dhe vandin e materialeve me përbajtje asbesti.

67. Letra nuk është shoqëruar me dokumente faktike.

Dispozitat e zbatueshme lidhur me çështjen

68. Ligji nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, i cili rregullon sistemin e integruar për mbrojtjen e mjedisit, zvogëlimin e rrezikut për ndotjen e mjedisit, jetën dhe shëndetin e njeriut sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm, ka për synim përmirësimin e kushteve mjedisore, që lidhen me cilësinë e jetës dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut.
69. Një ndër parimet në të cilat bazohet Ligji nr. 04/L-060 për Mbeturinat, qëllimi i të cilit është parandalimi i ndikimeve negative të mbeturinave në mjedis dhe në shëndetin e njeriut, si dhe deponimin përfundimtar të mbeturinave në mënyrë të pranueshme mjedisore, në nenin 5, par. 3 “Parimet për menaxhimin e mbeturinave”, ka paraparë “Parimin e vigilencës dhe parandalimit”, i cili obligon autoritetet të ndërmarrin masa inkurajuese dhe parandaluese për menaxhimin e mbeturinave:

“3.1. autoritetet publike kur është e nevojshme, ndërmarrin dhe inkurajojnë veprime parandaluese në menaxhimin e mbeturinave”.
70. Në vazhdim Ligji në nenin 5 “Parimi për menaxhimin e mbeturinave i sistemuar sipas

prioriteteve”, në nënparagrafin 5.1.5 parasheh që deponimi i mbeturinave duhet të bëhet pa shkaktuar ndikime negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

71. Ndërsa nen 8 i Ligjit ka precizuar “Parimin e qasjes së publikut në informata”, ka përcaktuar jo vetëm të drejtën e qytetarëve për qasje në informata që kanë të bëjnë me aktivitetet e menaxhimit të mbeturinave, por edhe pjesëmarrjen e tyre në vendimmarrje.

“8.1. në pajtim me parimet e përfshira në Konventën e Aarhus-it, të gjithë personat kanë të drejtë edhe nëse nuk janë pale të involvuar, të kenë qasje në çfarëdo informate që kanë të bëjnë me aktivitetet e menaxhimit të mbeturinave...”.

72. Mirëpo, Ligji për Mbeturinat, në nenin 47 “Menaxhimi i mbeturinave që përmbajnë azbest”, ka rregulluar në mënyrë precise çështjen e menaxhimit të mbeturinave të asbestit, obligimet e personave që menaxhojnë mbeturinat në fjalë, mënyrën e deponimit, kushtet për mbrojtjen e mjedisit, si dhe mënyrën e regjistrimit të mbeturinave:

1. *Personat të cilët menaxhojnë mbeturinat që përmbajnë asbest duhet të jenë të licencuar.*
2. *Mbeturinat që përmbajnë asbest mblidhen të ndara, paketohen, magazinohen ose deponohen në vendin e caktuar për këto lloje të mbeturinave, i cili duhet të jetë i shënuar.*
3. *Prodhuesi i produkteve nga asbesti dhe zotëruesi i mbeturinave që përmbajnë asbest është i detyruar që të ndërmerr të gjitha masat që fijet e asbestit dhe pluhuri të mos emitohen në mjedis.*
4. *Zotëruesi i mbeturinave që përmbajnë asbest është i detyruar po ashtu të mbajë evidencën dhe shënimet për sasinë e mbeturinave që i magazinon ose i deponon, dhe shënimet për këtë ia dorëzon Ministritë.*
5. *Ministri me akt nënligjor përcakton mënyrën e paketimit, trajtimit dhe kushtet e kriteret për magazinimin ose deponimin e mbeturinave”.*

73. Udhëzimi Administrativ nr. 22/2015 për Menaxhimin e Mbeturinave që Përmbajnë Azbest, në mënyrë specifike ka paraparë përcaktimin e kushteve për menaxhimin e mbeturinave që përmbajnë asbest, masave për parandalimin e ndotjes së mjedisit me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të njeriut.

74. Udhëzimi ka paraparë në mënyrë të detajuar kufizimet ku nuk mund të kryhet deponimi i mbeturinave, parandalimin e ndotjes me asbest, trajtimin e mbeturinave, detyrimet e personave të cilët menaxhojnë mbeturinat, shënjimin, obligimet e autoriteteve kompetente dhe mbikëqyrjen inspektive.

Instrumentet relevante ligjore

75. Mbrojtja e mjedisit është e renditur në vlerat në të cilat bazohet rendi kushtetues i Republikës së Kosovës. Neni 7 [Vlerat] Kushtetuta e Republikës së Kosovës “...bazohet në parimet e ...respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, mbrojtjes së mjedisit...”.

76. Kushtetuta i ka dhënë hapësirë dhe rëndësi të veçantë mjedisit dhe mbrojtjes së tij, duke e renditur në nenin 52 [Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor], të kapitullit II “Të Drejtat dhe Liritë Themelore”. Kushtetuta ka obliguar “*secilin*”, duke mos bërë dallime në mes personave fizikë dhe juridikë, për mbrojtjen e mjedisit.

*“1. Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare janë përgjegjësi për *secilin*”.*

77. Kushtetuta në nenin 25 ka garantuar të drejtën për jetën. [E Drejta për Jetën]

“Secili individ gëzon të drejtën për jetën”.

78. Një ndër instrumentet ndërkombe të që garanton të drejtat dhe liritë e njeriut, e paraparë në nenin 22 të Kushtetutës [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombe], është Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj.

79. Në mënyrë që të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutën e vendit interpretohen në pajtim me vlerat e shoqërisë së hapur dhe demokratike dhe në pajtim me praktikat e organeve ndërkombe, të cilat i mbikëqyrin ato, Kushtetuta në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] ka precizuar që:

“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”.

80. Edhe pse Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe protokollet e saj nuk kanë parashikuar ndonjë të drejtë për mjeshtërinë shëndetshëm, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj) vazhdimesh ka zhvilluar jurisprudencën e saj në çështjet mjeshtërisore, për shkak të faktit se ushtrimi i të drejtave të caktuara të Konventës mund të preket nga vetë ekzistencia e dëmeve dhe ndotjes së mjeshtërisit, si dhe eksposimit të individëve në mjeshtëri që përbajnjë rrezik.

81. Gjykata tashmë në praktikën e vet ka identifikuar se çështjet e ndryshme mjeshtërisore mund të ndikojnë në nenin 2 [E drejta për jetën], nenin 8 [E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare], nenin 6 [E drejta për një proces të irregullt] gjykim të drejtë dhe qasje në gjykatë, nenin 10 e drejta për të marrë dhe jap informacion [Liria e shprehjes], nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive], dhe nenin 1 i Protokollit nr. 1 [E drejta e pronës].

82. Lidhur me ndikimin e mjeshtërisit në të drejtat e njeriut, GjEDNj-ja ka theksuar se autoritetet publike janë të detyruara të marrin masa për të siguruar që të drejtat e njeriut të mos preken seriozisht nga faktorë të dëmshëm mjeshtërisor.

83. GjEDNj-ja në interpretimet e veta u ka dhënë vend të rëndësishëm informatave mjeshtërisore në të drejtën për mjeshtërinë shëndetshëm. Gjykata ka theksuar se autoritetet publike duhet të respektojnë plotësimin e kërkesave rrëth informimit dhe komunikimit, si dhe çështjes së pjesëmarrjes në proceset vendimmarrëse dhe qasjes në drejtësi lidhur me rastet mjeshtërisore.

Situata në Komuna

84. Avokati i Popullit, pas analizës së gjendjes në 7 komunat e Kosovës (komunën e Prishtinës, Prizrenit, Pejës, Mitrovicës, Gjilanit, Ferizajt dhe Gjakovës), vëren se të gjitha komunat, përveç Komunës së Mitrovicës, nuk kanë ndërmarrë veprime për menaxhimin e mbeturinave që përbajnjë asbest, ashtu sikurse parashihet në Ligjin për Mbeturinat dhe Udhëzimin Administrativ nr. 22/2015 për Menaxhimin e Mbeturinave që Përbajnjë Azbest.
85. Edhe pse sipas Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, mbrojtja e mjedisit dhe menaxhimi i mbeturinave është përcaktuar si kompetencë ekskluzive e komunave, megjithatë komunat nuk i kanë ndërmarrë veprimet e duhura për menaxhimin e mbeturinave me asbest në pajtim me legjislacionin në fuqi. Madje vërehet se disa nga komunat nuk e kanë mjaftueshëm të qartë detyrën e tyre për menaxhimin e mbeturinave me përbajtje asbesti, edhe pse në nenin 15 të Ligjit për Mbeturinat përcaktohen saktë “Përgjegjësitë dhe detyrat e komunës”.
86. Asnjëra nga përgjigjet e pranuara nga komunat nuk është përcjellë me dokumente faktike, të cilat do të dokumentonin planet komunale për mbledhjen, grumbullimin dhe ndarjen e mbeturinave të rrezikshme, në rastin konkret mbeturinave të asbestit nga mbeturinat tjera⁴. Shqetësues është fakti se asnjëra nga komunat nuk kanë evidencë lidhur me vendet e ndotura brenda territorit të tyre.
87. Lidhur me pyetjen e Avokatit të Popullit, të bazuar në nenin 11, paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ nr. 22/2015 për Menaxhimin e Mbeturinave që Përbajnjë Azbest, që ka të bëjë me caktimin e lokacionit për deponimin e mbeturinave që përbajnjë asbest, Avokati i Popullit është njofuar se asnjëra nga komunat, përveç komunës së Mitrovicës, nuk ka caktuar lokacion për deponimin e mbeturinave me asbest.
88. Edhe pse sipas nenit 11, par. 1 të Udhëzimit Administrativ “Obligimet e Autoriteteve Kompetente”, parashihet që autoriteti komunal është i obliguar për caktimin e lokacionit dhe vendit për deponimin e mbeturinave me asbest, asnjëra nga komunat (përashtuar komunën e Mitrovicës), nuk ka paraparë vendin për deponimin e mbeturinave në fjalë.
89. Madje, vetë mungesa e informatave lidhur me personat e licencuar nga Ministria, sjell me automatizëm faktin për dështimin e autoriteteve komunale për zbatimin e obligimit që del nga par. 4, i nenit 11 të UA, që “*Personat e licencuar nga Ministria për menaxhimin e mbeturinave që përbajnjë azbest duhet të marrin leje nga organi kompetent komunal për caktimin e lokacionit për vendosjen e mbeturinave*”.
90. Edhe pse nen 15 të Ligjit për Mbeturinat, përgjegjësitë dhe detyrat e komunës thotë se “*Dy apo më shumë komuna, kur është interes i tyre, mund të bëjnë marrëveshje për menaxhimin e mbeturinave*”, nuk ka ndonjë informatë se ato kanë shqyrtau mundësinë për caktimin e lokacionit të përbashkët me ndonjë komunë tjetër, si masë proporcionale duke marrë parasysh koston e lartë për menaxhim të pranueshëm të lloji të mbeturinave në fjalë, ashtu sikurse parashihet.

⁴ Ligji për; A NM./ Mbeturinat, nen 10, par. 6. 7, “*Plani i Republikës së Kosovës dhe komunave për menaxhimin e mbeturinave*”.

91. Ligji për Mbeturinat, cakton se mbledhjen, grumbullimin, transportimin, trajtimin, përpunimin, magazinimin, riciklimin dhe deponimin e mbeturinave e bën vetëm personi i licencuar. Po ashtu, sipas nenit 6, par. 3 të Udhëzimit Administrativ “*Personi që menaxhon azbest duhet të pajiset me Licence për menaxhimin e mbeturinave*”. Nga përgjigjet vërehet që nuk janë ndërmarrë veprime në këtë drejtim, pavarësisht se në rastin konkret kemi të bëjmë me asbestin, i cili sipas Ligjit renditet në grupin e mbeturinave të veçanta⁵.

92. Komunat, nuk kanë arritur të prezantojnë ndonjë informatë se është lejuar vendosja e mbeturinave në fjalë në ndonjë vend ku nuk shkaktohet ndotja e mjedisit.

“Varësisht nga natyra e mbeturinave me asbest, autoriteti komunal mund të lejojë vendosjen ose deponimin e tyre në vendet ku vlerësohet që nuk shkaktohet ndotja e mjedisit”⁶.

93. Nga përgjigjet kuptohet se komunat nuk kanë qenë në gjendje të ofrojnë informata se a e kanë përbushur obligimin e vet ligjor për mbikëqyrjen e personave që menaxhojnë asbest.

“Autoriteti komunal është i detyruar që përmes inspektoratit komunal të mbikëqyr personat që menaxhojnë me mbeturinat me asbest”⁷.

94. Vërehet se, përkundër obligimit që Ligji për Mbeturinat përcakton ekskluzivisht që planet komunale duhet të përbajnjë programet për ngritjen e vetëdijesimit dhe arsimimit të publikut lidhur me menaxhimin e mbeturinave, në rastin konkret mbeturinave të asbestit, komunat në përgjigjet e tyre drejtuar Avokatit të Popullit nuk kanë arritur të ofrojnë fakte bindëse se në planet e tyre kanë integruar edhe programet për ngritjen e vetëdijesimit dhe arsimimit të publikut, e cila në këtë fazë do të ishte masë efektive për parandalimin e ndikimit të ndotjes me asbest në mëdisit dhe në shëndetin e njeriut.

Analiza ligjore

95. Edhe pse në mungesë të bashkëpunimit të MMPH-së, si organi më kompetent i nivelit qendror, Avokati i Popullit, duke pasur parasysh që shteti është përgjegjës për aktivitetet që janë të dëmshme për mëdisin, si ato që kryhen nga autoritetet publike ose nga një person privat apo kompani⁸, vlerëson se institucionet shtetërore të nivelit lokal dhe qendror, përgjegjëse për menaxhimin e mbeturinave, në rastin konkret menaxhimit të asbestit si mbeturinë e veçantë⁹, përkundër rrezikut për jetën dhe shëndetin e njeriut¹⁰, nuk kanë ndërmarrë veprime konkrete si obligim pozitiv, që do të ishin masa efektive për menaxhimin e mbeturinave me përbajtje të asbestit.

⁵ Ligji për Mbeturinat, nen 38 Menaxhimi i mbeturinave të veçanta, par. 4.8 “Mbeturinat që përbajnjë azbest”.

⁶ Po aty, nen 11, par. 2.

⁷ Po aty, nen 11, par. 3.

⁸ Karta Sociale Evropiane, Kapitulli I: “E Drejta për Mbrojtjen e Shëndetit dhe Mjedisit”.

⁹ Ligji nr. 04/L-060 për Mbeturina, “Mbeturina të veçanta”, nen 38.

¹⁰ http://www.who.int/ipcs/assessment/public_health/asbestos/en/, “*Të gjitha llojet e asbestit shkaktojnë kancer të mushkërive, mesothelioma, kancer në laring dhe ovarian, dhe asbestozë (fibroza e mushkërive)*”.

96. GjEDNJ, në rastin *L.C.B. v. the United Kingdom*, ka dhënë mendimin se shtetet kanë obligim pozitiv që të marrin masat e duhura për të mbrojtur jetën e qytetarëve brenda juridikzionit të tyre.
97. Avokati i Popullit, nga analiza e legjislacionit në fuqi, që rregullon çështjen e menaxhimit të mbeturinave me asbest, konsideron se legjislacioni në fuqi rregullon mjaftueshëm çështjen se ku nuk duhet bërë deponimi i mbeturinave me përmbajtje asbesti; hapat për parandalimin e ndotjes së mjedisit; mënyrën e trajtimit të mbeturinave në fjalë; transportimin, magazinimin dhe deponimin; obligimet e autoriteteve; menaxhimin dhe mbajtjen e shënimeve; dhe mbikëqyrjen administrative dhe inspektive.
98. Mirëpo, në dy dokumentet themelore për planifikimin dhe menaxhimin e mbeturinave – “Strategjinë e Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave 2013-2022”, “Planin e Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave 2013-2017”, nuk vërehet që mbetjeve me përbërje asbesti i është kushtuar rëndësi e veçantë. Asbesti, në të dy dokumentet është përmendur vetëm në rastin e “*Pastrimi i lumi Lepenc nga mbeturinat e azbestit*”.
99. Avokati i Popullit konsideron se mosarritja e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për t’iu përgjigjur kërkesës së Avokatit të Popullit, me informata përmes së cilave do të dokumentonte masat e ndërmarra për menaxhimin e mbeturinave me përmbajtje asbesti si mbeturina të veçanta sipas kriterieve të përcaktuar me Ligjin për Mbeturinat, është dëshmi për dështimin e Ministrisë si autoritet kompetent për zbatimin e dispozitave ligjore të Ligjit për Mbeturina, të cilat qytetarëve do t’u siguronin mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm.
100. Mosarritja e MMPH-së për të ofruar fakte për veprimet e ndërmarra për trajtimin e mbeturinave me përmbajtje asbesti si masa parandaluese për evitimin e ndikimit mbeturinave në mjedis dhe shëndetin e njeriut, është tregues i mjaftueshëm i dështimit të pritshmërisë që duhej të prodhonte neni 1, par. 1.4 i Ligjit për Mbeturinat, i cili ka për qëllim “*Parandalimin e ndikimeve negative të mbeturinave në mjedis dhe shëndetin e njeriut*”.
101. Madje ligji në nenin 5, par. 3 “Parimi i vigilencës dhe parandalimit”, thekson se:
- “autoritetet publike kur është e nevojshme, ndërmarrin dhe inkurajojnë veprime parandaluese në menaxhimin e mbeturinave”.*
- Duke pasur parasysh dyshimin e bazuar në argumente shkencore të ndikimit të asbestit në shëndetin e njeriut dhe mjedis, ndërmarrja e masave nga shteti në përputhje me ligjin do të ishte masë parandaluese dhe masë efektive, e cila do ta mbante në kontroll gjendjen.
102. Avokati i Popullit konsideron se neglizhenca e Ministrisë për t’u angazhuar lidhur me çështjen e menaxhimit të mbeturinave ka rezultuar me mungesë të informatave, të cilat do ta dëshmonin punën e Ministrisë drejt zbatimit të dispozitave të Ligjit dhe Udhëzimit Administrativ që rregullon menaxhimin e mbeturinave me asbest. Një sistem efektiv i informimit do t’i garantonte publikut pjesëmarrje në vendimmarrje dhe qasje në drejtësi.
103. Për më tepër, edhe përkundër mospërmbushjes së obligimeve sipas Ligjit dhe UA, bazuar

në informatën e pranuar nga ish-ministrja Reshitaj, edhe përkundër rrezikut për jetën, Ministria dhe komunat nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim informativ, si masë parandaluese, e cila do ta vetëdijesonte publikun për rrezikun ndaj mjedisit dhe shëndetit të njeriut nga menaxhimi joprofesional i materialeve me përbajtje të asbestit.

104. Avokati i Popullit sjell në vëmendje se e gjithë baza ligjore e legjislacionit mjedisor në Kosovë, por edhe vetë Ligji për Mbeturina, ka të ngërthyer në vete Parimin e qasjes së publikut në informata¹¹, i cili i garanton të gjithëve qasje në informatat që kanë të bëjnë me mjedisin.

“në pajtim me parimet e përfshira në Konventën e Aarhus-it, të gjithë personat kanë të drejtë edhe nëse nuk janë pale të involvuar, të kenë qasje në çfarëdo informatë që kanë të bëjnë me aktivitetet e menaxhimit të mbeturinave si dhe të drejtën dhe mundësinë e pjesëmarrjes në vendimmarrje për mbeturina”.

105. GjEDNj-ja në rastin *Öneryıldız v. Turkey* lidhur me dështimin e autoriteteve për informimin e publikut dhe për ndërmarrjen e masave efektive dhe parandaluese, kishte gjetur shkelje të nenit 2, për arsyen e mungesës së ndërmarrjes së hapave të duhur nga shteti për të parandaluar vdekjen e nëntë banorëve që jetonin pranë një deponie mbeturinash. Gjykata vuri në dukje në veçanti mungesën e informimit të banorëve lidhur me rrezikun që ata ballafqoheshin duke jetuar në atë vend. Sipas gjykates, edhe nëse do të kishte informata, shteti është përgjegjëse, pasi që nuk kishte ndërmarrë masat e nevojshme praktike për të shmangur rreziqet për jetën e njerëzve.

106. MMPH-ja nuk ka arritur po ashtu të informojë Avokatin e Popullit lidhur me masat për vetëdijesimin e publikut për ndikimin e asbestit në shëndetin e tyre dhe në mjedis, e po ashtu për vetëdijesimin e publikut për mënyrat e trajtimit të materialeve në fjalë, edhe pse Ligji përcakton qartë parimin e vigjilencës. Sipas nenit 10, par. 6.13 të Ligji për Mbeturinat, decidivisht parashihet që Plani i Republikës së Kosovës dhe Planet e komunave për menaxhimin e mbeturinave duhet të përbajnë edhe “*programet për ngritjen e vetëdijesimit dhe arsimimit të publikut lidhur me menaxhimin e mbeturinave*”.

107. Në rastin *Dubetska dhe të tjerët v. Ukrainës*¹², GjEDNj lidhur me problemet kronike shëndetësore të banorëve nga ndikimi i ndotjes në mjedisin jetësor theksoi se nuk ka dyshim se ndotja mund të ndikojë negativisht në shëndetin publik në përgjithësi, dhe përkeqëson cilësinë e jetës së një individi, edhe pse shpesh është e pamundur për të përcaktuar efektin e saj në secilin rast individual. Gjykata më tej theksoi se, të jetosh në një zonë me tejkalime të qarta të standardeve të lejuara nga ndotja, përbën rrezik të lartë për shëndetin. Gjykata gjeti shkelje të nenit 8, pasi që autoritetet nuk kishin gjetur një zgjidhje efektive për situatën në mënyrën për të frenuar ndotjen.

108. Sipas Dokumentit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë (WHO) dhe Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), të publikuar në vitin 2007, që ka të bëjë me Zhvillimin e programeve kombëtare për eliminimin e sëmundjeve të lidhura me asbest “*Eksposimi ndaj asbestit shkakton asbestozë, pllaka pleurale, trashje dhe effusions, kancer të*

¹¹ Ligji për Mbeturinat, nen 5, par. 8, “*Parimi për qasje të publikut në informata*”.

¹² *Dubetska and Others v. Ukraine*, paragraph 105;

mushkërive, Mesothelioma, laryngeal dhe ndoshta kanceret e tjera me periudha të ndryshme latente”.

109. Ministria, si organ kompetent, ka dështuar po ashtu të ofrojë përgjigje lidhur me personat e licencuar, kur dihet që është përgjegjëse jo vetëm për lëshimin e licencës, por edhe mbajtjen e evidencës për personat e licencuar. Ligji në nenin 14, par. 1.4, ka caktuar që një ndër “Kompetencat e Ministrisë për zbatimin e dispozitave të këtij ligji janë: “lëshimin e licencës për menaxhimin e mbeturinave dhe mbajtja e evidencës në regjistrin për licencë”.
110. Më tutje, neni 47, par. 1 i Ligjit për Menaxhimin e mbeturinave që përmbajnë azbest, saktëson se ”Personi që menaxhon mbeturinat që përmbajnë azbest duhet të pajiset me Licencë për menaxhimin e mbeturinave”. Çështjen e licencimit e rregullon edhe neni 6, par. 3 i Udhëzimit Administrativ nr. 22/2015 për Menaxhimin e mbeturinave që përmbajnë azbest.
111. Andaj, sipas Avokatit të Popullit, shqetësues është fakti se autoritetet kompetente nuk kanë arritur të dëshmojnë apo ofrojnë informata se a ka persona të licencuar për menaxhimin e mbeturinave me përbajtje asbesti, përkundër ndikimit në shëndet dhe mjedis të materialit në fjalë.
112. Organizata Botërore e Shëndetësisë (WHO) në dokumentin e publikuar në vitin 2014 ”Eliminimi i sëmundjeve të lidhura me azbestin”, i cili shqyrton efektet negative të ekspozimit në asbestit në shëndet, vlerëson se të paktën 107 000 njerëz vdesin çdo vit nga kanceri në mushkëri, si rezultat i ekspozimit në asbestozë gjatë ushtrimit të profesionit.
113. Përkundër një dështimi të vazhdueshëm për përbushjen e obligimeve nga organet e nivelit lokal, si përgjegjës për mjedisin jetësor, MMPH-ja, si organ kompetent për menaxhimin e mbeturinave që përmbajnë azbest, nuk ka ofruar asnjë informatë në pyetjen e Avokatit të Popullit lidhur me mbikëqyrjen inspektive dhe cilat veprime janë ndërmarrë, edhe pse Ligji e ka përcaktuar saktësish në nenin 14, par. 1 të Udhëzimit Administrativ nr. 22/2015 për Menaxhimin e mbeturinave që përmbajnë azbest, që ”Mbikëqyrja administrative e menaxhimit të mbeturinave që përmbajnë azbest bëhet sipas nenit 61 dhe 62 të Ligjit për Mbeturina”. Avokati i Popullit gjen që Ligji e ka përcaktuar saktë që ”Mbikëqyrjen administrative për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe dispozitave të nxjerra në bazë të tij e kryen Ministria”.
114. Neni 62 i Ligjit për Mbeturina nuk ka lënë asnjë hapësirë që të hapë dyshime për kompetenca. ”Mbikëqyrjen inspektive për zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe dispozitave të nxjerra në bazë të tij, kushtet dhe mënyrën e punës së personave të mbikëqyrur si dhe ndërmarrjen e masave për mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e njeriut nga mbeturinat, të përcaktuara me këtë ligj e bën Inspektorati Mjedisor i Ministrisë”.
115. Praktika e GjEDNj-së, në kuadër të nenit 2 të Konventës [E drejta për jetën], jep mendimin që shteti duhet të vendosë detyrime pozitive për të marrë masat e nevojshme për të mbrojtur jetën e qytetarëve brenda juridikzionit të tij¹³. Neni 2 i obligon autoritetet

¹³ *L.C.B. v. the United Kingdom, judgment of 9 June 1998, paragraph 36;*

publike të ndërmarrin hapa për të garantuar të drejtat e Konventës, madje edhe kur të drejtat kërcënohen nga persona të tjerë (privatë) ose aktivitetet që nuk janë drejtpërdrejt të lidhura me shtetin. Sipas Gjykatës, obligimi pozitiv i shteteve mund të aplikohet në kontekst të aktiviteteve të rrezikshme, funksionimit të fabrikave të kimikateve me emetime toksike, ose vendeve të grumbullimit të mbetjeve, qoftë të transportuara nga vetë autoritetet publike ose nga kompani private. Në përgjithësi, shkalla e detyrimeve të autoriteteve publike varet nga faktorët se sa është ndikimi i aktiviteteve të rrezikshme dhe parashikimi i rrezikut për të jetën¹⁴.

116. MMPh-ja, përkundër faktit për përgjegjësinë kushtetuese për mbrojtje të mjedisit, nuk ka arritur të respektojë parimin e qasjes së publikut në informata lidhur me dokumentet që përbajnë informata mjedisore. Vërehet se MMPh-ja nuk e ka publikuar raportin e OJQ “*Pro Vitae*”, pavarësisht se përmban informata për hulumtimin e asbestit në të gjitha ndërtesat publike në Komunën e Pejës dhe në atë të Istogut, edhe pse nuk ka arritur të arsyetojë kufizimin e së drejtës për qasjes në informata.
117. Për më tepër, edhe pse Ligji për Avokatin e Popullit, në mënyrë decidive parashevë të drejtën e qasjes së Avokatit të Popullit në të gjitha dosjet dhe në dokumentet e çdo autoriteti të Republikës së Kosovës, Ministria ka refuzuar që të ofrojë qasje në raportin për hulumtimin e asbestit në të gjitha ndërtesat publike në Komunën e Pejës dhe të Istogut i OJQ “*Pro Vitae*”.
118. Lidhur me kufizimin e pabazuar në Ligjin për qasjes në dokumente publike, Avokati i Popullit, ju sjell në vëmendje nenin 41 [E drejta e qasjes në dokumente publike] të Kushtetutës, i cili i garanton secilit të drejtën e qasjes në dokumente publike “*Secili person gëzon të drejtën të qasjes në dokumente publike*”, dhe parashevë decidivisht se kufizimi i së drejtës mund të bëhet vetëm me ligj dhe për arsyë të caktuara.

“Dokumentet që mbajnë institucionet publike dhe organet e pushtetit shtetëror, janë publike, me përashtim të informacioneve që janë të kufizuara me ligj, për shkak të privatësisë, të sekreteve afariste ose të informacioneve të klasifikuara të sigurisë”.
119. Lidhur me mospërmbushjen e obligimit të shtetit për informim lidhur me ndikimin e asbestin në shëndetin e njeriut dhe në mëdis, GjEDNj-ja në rastin *Roche v. the United Kingdom* kishte konstatuar shkelje të nenit 8 të Konventës në rrethana të përgjithshme, pasi që shteti nuk kishte përbushur detyrimin e saj pozitiv për të siguruar një procedurë efektive dhe të qasshme, që ia mundësonte aplikuesit të ketë qasje në të gjitha mjetet relevante dhe në informacione të përshtatshëm që do t'i lejonte të vlerësonë çdo rrezik ndaj të cilës i ishte i ekspozuar.
120. Përkundër lëshimeve të vazhdueshme, Avokati i Popullit nuk ka gjetur as përmes burimeve tjera, që Ministria ka orientuar politikat që menaxhimi i mbeturinave të bëhet sipas metodave të pranueshme mjedisore, duke ndërmarrë masa shtesë dhe të shpejta ashtu si parashihet në nenin 38 të Ligjit nr. 04/L-060 për Mbeturina “*Menaxhimi i mbeturinave te veçanta*”.

¹⁴ *Öneryıldız v. Turkey [GC]*, paragraph 73; *L.C.B. v. the United Kingdom*, paragraphs 37-41.

“Menaxhimi i mbeturinave të veçanta nga neni 4. paragrafi 1, nën-paragrafi 1.15 i këtij ligji, bëhet sipas metodave, të cilat nuk paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Ministri ndërmerr masa shtesë për menaxhimi e mbeturinave të veçanta, nëse mbeturinat dhe çfarëdo veprimi me mbeturina rrezikojnë mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Qeveria është e detyruar të ndërmerr masa të shpejta për parandalimin e rrezikut, nëse vlerëson se ato mund të paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut”.

121. Avokati i Popullit gjen se gjykata në rastet *Öneryildiz v. Turkey*, par. 93 dhe *Budayeva and Others v. Russia*, par. 140, ka theksuar se rastet që në veçanti kanë të bëjnë me veprimitari të rrezikshme, kur autoritetet publike janë plotësish të vetëdijshme për pasojet e mundshme dhe nuk i ushtrojnë përgjegjësitë e tyre për evitimin e rrezikut, duke mos arritur të marrin masa që janë të nevojshme dhe të mjaftueshme për t'ishmangur rreziqet që mund të shkaktojnë edhe humbje të jetës, dhe shkelje të nenit 2 të KEDNj-së, kërkohet që përgjegjësit për rrezikim të jetës të ngarkohen me vepër penale apo të ndiqe penalisht.

Dështimi i MMPH-së për bashkëpunim me Avokatin e Popullit

122. Edhe pse Kushtetuta e Republikës së Kosovës, në nenin 132, paragrafi 3, parashev decidivisht obligimin e të gjitha institucioneve për t'u përgjigjur në kërkesat e Avokatit të Popullit, MMPH-ja, përkundër kërkesave të vazhdueshme në formë të shkruar, në mënyrë elektronike dhe përmes kontakteve të drejtpërdrejta në mes të Avokatit të Popullit dhe ministres së atëhershme, nuk ofroi asnjë përgjigje lidhur me çështjen e menaxhimit të mbeturinave me përbajtje të asbestit.

“Çdo organ, institucion ose autoritet tjeter, që ushtron pushtet legitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuar në pajtim me ligjin”.

123. E paarsyetuar dhe e pakuptueshme mbetet mospërgjigja e MMPH-së për të ofruar informatat lidhur me raportin e OJQ “*Pro Vitae*”, që kishte të bënte me hulumtimin e asbestit në të gjitha ndërtesat publike të komunës së Pejës dhe të Istogut, përkundër obligimit kushtetues dhe ligor nuk i është përgjigjur Avokatit të Popullit në kërkesën e tij për t'u informuar lidhur me çështjen.

124. Avokati i Popullit ua sjellë në vëmendje personave kompetentë në Ministri se Ligji për Avokatin e Popullit nr. 05/L-019 ka përcaktuar detyrimin e të gjitha autoriteteteve për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit. Sipas nenit 18, paragrafi 6 të Ligjit, parashihet që:
- “Avokati i Popullit ka qasje në dosjet dhe në dokumentet, të çdo autoriteti të Republikës së Kosovës, ...mund të kërkojë nga çdo autoritetet i Republikës së Kosovës dhe nga personeli i tyre të bashkëpunojnë me Avokatin e Popullit, duke siguruar informacione relevante, përfshire edhe kopjen e plotë apo të pjesshme të dosjes dhe dokumenteve sipas kërkesës së Avokatit të Popullit”.*

125. Ndërsa neni 25 i Ligjit për Avokatin e Popullit ka paraparë vetëm obligimin për bashkëpunim, por edhe pasojet e refuzimit.

- 1. Të gjitha autoritetet kanë për obligim t'i përgjigjen Avokatit të Popullit në kërkesat e tij për zhvillimin e hetimeve, si dhe t'i ofrojnë ndihmë adekuate sipas kërkesës së tij.*
- 2. Refuzimi për të bashkëpumuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose nga autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga organi kompetent fillimin e procedurës administrative duke përfshirë marrjen e masave disiplinore, deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil”.*
126. Në veçanti, Avokati i Popullit, ju rikujton paragrafin 3 të nenit 25, i cili përcakton se situatat kur institucionet nuk bashkëpunojnë me Avokatin e Popullit, dhe të drejtë që të kërkojë nga prokuroritë fillimin e procedurave:
- “ Në rastin kur institucioni refuzon të bashkëpunojë ose ndërhyjnë në procesin e hetimit, Avokati i Popullit ka të drejtë të kërkojë nga prokuroria kompetente fillimin e procedurës ligjore, për pengimin e kryerjes së detyrës zyrtare ”.*
- Konstatimet**
127. Avokati i Popullit, pas analizës së çështjes, konsideron se, pavarësisht bazës së mjaftueshme ligjore që ofron Ligji nr. 04/L-060 për Mbeturina dhe Udhëzimi Administrativ nr. 22/2015 për Menaxhimin e Mbeturinave që përmbajnë azbest, MMPH-ja dhe komunat, edhe pse janë të veshura me funksione për zbatimin e së drejtës dhe janë përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit jetësor, natyrës dhe biodiversitetit¹⁵, nuk kanë ndërmarrë veprime me të cilat do të siguronin një mjesid të sigurt dhe të shëndetshëm për qytetarët e Kosovës, si obligim pozitiv që del nga nen 25 [E drejta për jetën] dhe nen 52 [Përgjegjësia për mjesisin jetësor] të Kushtetutës.
128. Duke u bazuar në informatat e poseduara, vlerësohet se ende nuk është arritur të përcaktohen lokacionet për deponimin e mbeturinave që përmbajnë asbest (me përjashtim të Komunës së Mitrovicës). Asnjëra nga organet (Ministria dhe komunat) nuk kanë arritur të ofrojnë fakte se ku bëhet deponimi i mbeturinave me asbest, edhe pse sipas Udhëzimit Administrativ për Menaxhimin e mbeturinave që përmbajnë azbest, është e ndaluar të bëhet deponimi i tyre pa pëlqimin e autoriteteve kompetente dhe po ashtu përzierja me mbeturina tjera.
129. Në vazhdim vërehet se asnjëra nga autoritetet (Ministria dhe komunat) nuk ka ofruar informata se a ka apo jo persona të licencuar, se a kanë njojuri se shfrytëzuesit apo përdoruesit e produkteve që përmbajnë asbest cilat masa parandaluese i ndërmarrin që gjatë aktiviteteve të tyre të mos shkaktojnë ndotje të mjesidit me fibra. Madje autoritetet nuk kanë arritur të ofrojnë ndonjë informatë se personat që menaxhojnë mbeturina a i përbushin detyrimet ashtu sikurse parashihet në nenin 8 të Udhëzimit Administrativ nr. 22/2015 për Menaxhimin e mbeturinave që përmbajnë azbest.
130. Vlerësohet si tejet shqetësues fakti për mungesën e informatave për magazinimin, deponimin e mbeturinave që përmbajnë asbest, mënyrën e paketimit të sigurt, e aq më tepër, mungesa e shënjimit me shenja adekuate.

¹⁵ Komentar, Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 52.1, fq. 197.

131. Avokati i Popullit vlerëson se mosarritja për t'u informuar nga autoritetet qendore dhe lokale lidhur me Mbikëqyrjen Administrative dhe Inspektive, ashtu si parashihet në nenin 61, 62 dhe 63 të Ligjit për Mbeturina, dhe Udhëzimit Administrativ për Menaxhimin e mbeturinave që përmbajnë azbest, është rezultat i neglizhencës së autoriteteve për të mbajtur nën kontroll menaxhimin e një materiali me kaq ndikim negativ në mjedis dhe në shëndetin e njeriut.
132. Avokati i Popullit konstaton se mosndërmarrja e asnë aktiviteti sensibilizimi për vetëdijesimin dhe informimin e publikut për rrezikun që përmbajnë materialet me përmbajtje asbesti, tregon dështim dhe neglizhencë të autoriteteve kompetente për mbrojtjen e shëndetit dhe të jetës së njeriut, dhe njëherësh kufizim të së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm dhe të së drejtës për jetën.
133. Bazuar në të gjitha faktet e paraqitura më lart, Avokati i Popullit konstaton se mosarritja e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për të argumentuar veprimet e ndërmarra lidhur me trajtimin e materialeve me asbest brenda territorit të Republikës së Kosovës, ashtu sikurse parashihet në Ligj dhe Udhëzim Administrativ, është tregues i dështimit të saj si autoritet kompetent për zbatimin e obligimeve të dala nga neni 92 i Kushtetutës për ushtrimin e pushtetit ekzekutiv në pajtim me Kushtetutë dhe ligj dhe për zbatimin e ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës.
134. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh se “*Vetëm ligji ka autoritetin për përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve për personat juridik dhe fizik*”, me qëllim të respektimit të nenit 25 të Kushtetutës, [E drejta për jetën], dhe nenit 52 [Përgjegjësia për mjedisin jetësor], dhe në mënyrë që autoritetet me hapa të përshpejtuar të ndërmarrin masa efektive për menaxhimin e mbeturinave me përmbajtje asbesti, si dhe masave për parandalimin e ndotjes së mjedisit me asbest, dhe për mbrojtjen e mjedisit, në bazë të analizës së rastit dhe konstatimeve të arritura, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe nenin 18, paragrin 1.5 dhe 1.7 të Ligjit për Avokatin e Popullit:

REKOMANDON

- Qeveria, të ndërmarrë masa të shpejta¹⁶, për menaxhimin e mbeturinave me përmbajtje azbesti, ashtu si parashihet në Ligjin Nr. 04/L-060 për Mbeturina;
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të ndërmarrë masa shtesë¹⁷ për menaxhimin e mbeturinave me përmbajtje azbesti;
- Komunat në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor të ndërmarrin masa me hapa të përshpejtuar për zbatimin e obligimeve të dala


¹⁶ Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturina, neni 38, "Menaxhimi i mbeturinave te veçanta", par 3, "Qeveria është e detyruar të ndërmerr masa të shpejta për parandalimin e rrezikut, nëse vlerëson se ato mund të paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e njeriut", par 4. "Sipas këtij ligji mbeturinat e veçanta janë: ...4.8. mbeturinat që përmbajnë azbest";

¹⁷ Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturina, neni 38, "Menaxhimi i mbeturinave te veçanta", par 2, "Ministri ndërmerr masa shtesë për menaxhimi e mbeturinave të veçanta, nëse mbeturinat dhe çfarëdo veprimi me mbeturinë rrezikojnë mjedisin dhe shëndetin e njeriut".

nga Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturina dhe Udhëzimi Administrativ Nr. 22/2015, për Menaxhimin e Mbeturinave që Përmbajnë Azbest;

- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, të filloj informimin dhe ndërgjegjësimin, përmes formave të ndryshme për ndikimit të azbestit në shëndetin e njeriut dhe mjedis, si dhe mënyrat e menaxhimit;
- Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ta bëjë publike raportin për hulumtimin e azbestit në të gjitha ndërtesat publike në komunën e Pejës dhe Istogut, të OJQ “Pro Vitae”, në përjashtim të informatave të kufizuara me ligj.

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor i Kuvendit të Kosovës, të kërkojë nga Ministri i MMPH-së, përgjegjësi për mosndërmarrjen e masave të parapara në Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturina, Udhëzimi Administrativ Nr. 22/2015, për Menaxhimin e Mbeturinave që Përmbajnë AzbestNë pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Cdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t'u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t'i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuar në pajtim me ligj*”) dhe nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, ... duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditorë. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë*”), me mirësi ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerrni lidhur me këtë çështje.



Me nderime,
Hilmi Jashari
Avokat i Popullit